



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 09.09.2019  
Dokument parlamentar

**RAPORT**

**MBI SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 11225, DATË 15.07.2019 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 36/2019 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9900, DATË 10.04.2008 “PËR REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT”**

- *Hyrje*

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 20.06.2019, miratoi projektligjin “*Për një ndryshim në ligjin nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”*”, projektligji ky i cili u miratua në parim me 76 vota pro, 12 kundër dhe 7 abstenim nga 95 deputetë të pranishëm dhe në tërësi me 73 vota pro, 12 kundër dhe 10 abstenim nga 95 deputetë të pranishëm.

Me dekretin nr.11225, datë 15.07.2019, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim ligjin nr.36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 09.09.2019, Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11225, datë 15.07.2019 “*Për kthimin e ligjit nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”*”

Për të parashtruar arsyet e kthimit për rishqyrtim të Dekretit të Presidentit të Republikës, ishte e pranishëm Znj.Krisilda Fana, Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë pranë Presidentit të Republikës, ndërsa relatore u caktua deputetja Antoneta Dhima.

- **Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të Shtetit”**

Znj.Fana, në fjalën e saj parashtroi edhe njëherë arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, duke u mbështetur në këto pretendime (në mënyrë të përmbledhur):

Referuar relacionit shpjegues të Këshillit të Ministrave që ka shoqëruar propozimin e projektligjit, si dhe raportit të datës 17.06.2019 të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, rezulton se ndryshimi ligjor i miratuar synon të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë të shtetit që bëjnë pjesë në grupin A, duke e zëvendësuar miratimin e lëvrimit të tyre nga me vendim të Këshillit të Ministrave siç parashikon aktualisht ligji në fuqi, me një akt individual, “Urdhër të Kryeministrit”.

Nga shqyrtimi i ligjit nr. 36/2019, konstatohet se ndërmarrja e kësaj iniciative ligjore është e pajustificuar ligjërisht dhe për më tepër kjo mënyrë e re e lëvrimit të mallrave pjesë e rezervës shtetërore nëpërmjet Urdhërit të Kryeministrit, nuk garanton plotësisht mbrojtjen e interesit publik në procedurat e administrimit dhe lëvrimit të mallrave me vlerë që përbëjnë grupin kryesor të mallrave të rezervave të shtetit.

Bazuar mbi këtë arsyetim, të shpjeguar si më poshtë vijon, Presidenti i Republikës, vlerëson se ligj nr.36/2019, duhet kthyer në Kuvend, me qëllim rishikimin e tij për të vlerësuar objektivisht nëse miratimi i këtij ndryshimi në ligjin nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit” është vërtet i nevojshëm apo jo.

Ky ligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, që prej datës 10.04.2008, nuk është ndryshuar për një periudhë 11-vjeçare dhe implementimi i tij në praktikë, nuk rezulton të ketë sjellë ndonjë problematikë të theksuar, e cila të jetë bërë pengesë në veprimtarinë administrative të strukturave shtetërore të ngarkuara për zbatimin e tij.

Sipas nenit 2 të ligjit ekzistues nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, rezervat materiale të shtetit janë lëndët e para, materialet, produktet e gatshme, prodhimet dhe mjetet e tjera të domosdoshme për depozitimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre, ndërkohë që administrimi i tyre është lëvrimi, këmbimi, freskimi, plotësimi, ruajtja ose mirëmbajtja, heqja apo seleksionimi, huadhënia, blerja, shitja dhe çdo veprim tjetër, që mund të kryhet me rezervat materiale të shtetit.

Në po këtë nen në pikën 4 të tij, jepet përkufizimi i termit “lëvrim” ku sipas ligjit lëvrimi është dhënia, falas ose me pagesë, e rezervave materiale të shtetit.

Ndërkohë në nenin 3, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, përcaktohet se:

*“Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje*

*lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Rezervat materiale të shtetit përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare”.*

**Referuar dispozitës së mësipërme, është e qartë se Kuvendi i Shqipërisë ka vlerësuar të përcaktojë me ligj rëndësinë madhore që ka krijimi, administrimi dhe përdorimi i rezervave materiale të shtetit, të cilat përveç krijimit dhe rifreskimit permanent të tyre, përdoren kryesisht në ato raste kur vihet në rrezik jeta dhe shëndeti i popullatës, apo prona publike dhe private që në thelb të tyre bëjnë pjesë në ato marrëdhënie juridiko shoqërore mbrojtja e të cilave përbën interes të lartë publik.**

Pikërisht për nga shumëllojshmëria dhe rëndësia e materialeve që përbëjnë rezervat shtetërore, ligjvënësi në nenin 5, pika 3 të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, ka përcaktuar se:

*“ Lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje e sasi, e ndarë sipas grupeve, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.1128, datë 05.08.2008 ka miratuar listën përbërëse të mallrave rezervë shtetërore, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe limiti minimal për secilin artikull, ku në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi parashikohet dhe Grupi A, i mallrave rezervë material shtetërore si më poshtë:

#### **Lidhja nr. 1**

### **LISTA E MALLRAVE REZERVË MATERIALE SHTETËRORE, SIPAS GRUPEVE,**

#### **E NDARË NË LLOJE DHE SASI**

##### **GRUPI A**

<b>Nr.</b>	<b>Artikujt</b>	<b>Njësia Matëse</b>	<b>Gjendja orientuese e mallrave (Sasia)</b>	<b>Limiti minimal</b>
1.	Prodhime ari, argjendi, platini etj. të kësaj natyre	kg	Relative sipas burimit	relativ
2.	Mjete të rënda për çdo lloj transporti	copë	50	30
3.	Grurë	ton	600	300
4.	Mallra të ndryshme tepër vëllimorë	copë	Relative sipas burimit	relativ

Kuvendi i Shqipërisë, për lëvrimin e mallrave të Grupit A, që kanë një rëndësi të lartë dhe një vlerë të konsiderueshme për rezervat shtetërore, ka përcaktuar në nenin 10 pika 1, të ligjit nr.9900, datë 10.4.2008, se:

*“Lëvrime dhe shitje e mallrave rezervë të grupit A bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit”.*

Ndërkohë që me ndryshimet që propozohen të realizohen me ligjin nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, Kuvendi ka miratuar ndryshimin pikërisht të pikës 1, të nenit 10 të ligjit bazë. Sipas nenit 1 të ligjit nr. 36/2019, parashikohet se:

Pika 1, e nenit 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, ndryshohet si më poshtë:

*“1. Lëvrime dhe shitje e mallrave rezervë të grupit A bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.”.*

Pra sipas këtij ndryshimi në ligj, të gjitha mallrat e Grupit A, të cilat deri më tani, kanë qenë në kompetencë të Këshillit të Ministrave për të vendosur lëvrimin e tyre, nëpërmjet këtij ndryshimi ligjor propozohen që ato të lëvrohen me akt individual të Kryeministrit me propozimin e ministrit.

Siç u përmend edhe më sipër, ky ndryshim justifikohet nga qeveria dhe Kuvendi me të vetmin argument se thjeshtohet procesi i lëvrimit të mallrave rezervë shteti të grupit A, për shkak se miratimi i lëvrimit të mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti kolegjial, si ai i vendimit të Këshillit të Ministrave, dhe kjo sjell vonesa në daljen e aktit të miratimit dhe deri në lëvrimin e tyre.

**Presidenti i Republikës vlerëson se ky argument i Këshillit të Ministrave dhe i Kuvendit të Shqipërisë, nuk qëndron dhe nuk justifikon aspak ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore për miratimin e ndryshimeve në nenin 10 pika 1 të ligjit ekzistues.**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 100 përcakton ndër të tjera se Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9000, date 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligj ky në të cilin është përcaktuar faqe qartë, mënyra se si mbledhet, kush e thërret dhe si i merr vendimet qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 13 të këtij ligji përcaktohet se mbledhja e Këshillit të Ministrave **thirret nga Kryeministri, ose në mungesë dhe me porosi të tij, nga Zëvendëskryeministri.**

Pra, autoriteti që ka për detyrë dhe përgjegjësi që të thërrase mbledhjen e Këshillit të Ministrave, është vetë Kryeministri. Në këtë mënyrë rezulton se, ndryshimet e propozuara në ligjin nr.9900/2008, për t’i kaluar Kryeministrit një kompetencë të Këshillit të Ministrave, nën argumentin se Kryeministri mund të vonojë mbledhjen dhe vendimarrjen e këtij organi kolegjial, është absolutisht i pambështetur në ligj dhe krejtësisht i pajustificuar.

Për më tepër, ligji nr.9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ka parashikuar edhe ato raste kur mbledhja e Këshillit të Ministrave është e domodoshme të realizohet në mënyrë urgjente dhe në raste të jashtëzakonshme.

Konkretisht në nenin 14 të ligjit, parashikohet se: “ Në raste të veçanta, Këshilli i Ministrave thirret në mbledhje të jashtëzakonshme nga Kryeministri, ose në mungesë dhe me porosi të tij, edhe nga Zëvendëskryeministri. Në rastet e thirrjes së mbledhjes të jashtëzakonshme nuk zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji”.

Pra edhe sipas kësaj dispozite është parashikuar edhe zgjidhja e atyre situatave të jashtëzakonshme që bëjnë të pamundur zbatimin e rregullit se rendi i ditës dhe projektaktet që do të shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dërgohet 2 (ditë) përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

Pra është vetë ligji organik i Këshillit të Ministrave që e ka zgjidhur qartësisht se si veprohet në situata emergjente me rëndësi të jashtëzakonshme.

Në këtë mënyrë, referuar parashikimeve të ligjit nr.9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, rezulton se argumenti i përdorur për ndryshimin e nenit 10 pika 1 të ligjit nr. 9900/2008 “Për rezervat material të shtetit”, nuk qëndron dhe është ligjërish i pajustificuar, pasi Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të mbledhet në çdo kohë dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që të vështirësojë procesin vendimarrës të tij, përfshi këtu edhe vendimmarrjen për lëvrimin e mallrave pjesë e rezervës shtetërore.

Republika e Shqipërisë, ka në fuqi një bazë ligjore të shëndoshë që parashikon mbledhjen në urgjencë të Këshillit të Ministrave, për të ushtruar në çdo kohë përgjegjësitë dhe funksionet e tij.

Prandaj çdo aludim se lëvrimi i mallrave të rezervave të shtetit, mund të pengohet nga vonesa e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, nuk qëndron dhe është një argument fiktiv për të legjitimuar ndërhyrjen që po tentohet të realizohet në ligjin ekzistues nr.9900/2008.

**Për më tepër, nisur nga rëndësia dhe vlera që kanë mallrat e Grupit A të rezervave të shtetit është në interes të publikut të gjerë që kontrolli ndaj çdo veprimi administrativ mbi këto mallra të jetë maksimal dhe jo një marrëdhënie midis dy autoriteteve politik Ministër – Kryeministër, ku padyshim kjo marrëdhënie varësie midis tyre (Kryeministër-Ministër) mund të ndikojë drejtëpëdrejtë në objektivitetin e vendimmarrjes.**

**Presidenti i Republikës vlerëson se nisur nga natyra dhe lloji i mallrave të Grupit A, të rezervave të shtetit, është e domodoshme të ruhet standardi ligjor i vendosur prej 11-vjetësh, ku vendimmarrja mbi mënyrën e administrimit të mallrave të Grupit A, t'i lihet vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave.**

Presidenti i Republikës vlerëson se në zbatim të nenit 100 pika 1 të Kushtetutës, ku përcaktohet se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore është e detyrueshme që të gjithë anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet të jetë në dijeni dhe të japin mendimin e tyre për çdo lëvizje apo lëvrim të mallrave të rezervave shtetërore pjesë e kategorisë A, pasi ruajtja e këtij standardi kontrollues mbi këtë verimtarë garanton një mënyrë më objektive për të ruajtur të pacenuar interesin publik.

**Ndryshimet ligjore të mriatuar me ligjin nr. 36/2019, dobësojnë mekanizmat e kontrollit mbi këtë proces, si dhe ulin nivelin vendimarrës mbi mënyrën se si këto mallra do të administrohen dhe qarkullojnë në vijim, duke krijuar kështu një rrezik të shtuar që interesi publik të cenohet.**

- ***Baza ligjore e shqyrtimit të Dekretit***

Baza Ligjore mbi të cilën Komisioni për Sigurinë Kombëtare, shqyrton Dekretin e Presidentit është:

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 85 të saj përcakton se:***

*Neni 85*

- 1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
- 2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

- ***Rregullorja e Kuvendit, e cila në nenin 86 të saj përcakton se:***

*Neni 86*

*Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji*

- 1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.*
- 2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.*
- 3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.*
- 4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.*
- 5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.*
- 6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.*

7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.

8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

- **Argumentet ligjore kundër dekretit të Presidentit të Republikës**

Relatorja Znj.Dhima parashtroi argumentat kundër Dekretit të Presidentit, si më poshtë vijon:

Iniciativa ligjore për ndryshimin e pikës 1, të nenit 10 të ligjit nr. 9900, ishte një kërkesë e iniciuar nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, si organ i qeverisjes së përgjithshme, i cili në fushën e përgjegjësisë së tij ka administrimin e mallrave rezervë të shtetit dhe kryen lëvrimin e tyre sipas autorizimit të organeve kompetente, drejtorit të përgjithshëm për mallrat e grupit C, ministrit për mallrat e grupit B dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për mallrat e grupit A.

Aktualisht, sipas bazës ligjore në fuqi (neni 10, i ligjit 9900/2008), lëvrimi i mallrave të grupit B dhe C bëhet me anë të një akti individual, “urdhër ministri” dhe “urdhër i drejtorit të përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë dhe më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht, ndërsa lëvrimi i mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti të një organi kolegjal vendimi i Këshillit të Ministrave. Kjo lloj vendimmarrje kërkon një kohë të caktuar gjë e cila mund të sjell vonesa në miratimin e aktit dhe deri lëvrimin e mallrave.

Ndryshimi i propozuar ka për qëllim unifikimin e procedurës së lëvrimit të mallrave rezervë të shtetit të secilit grup nëpërmjet një akti individual të një organi monokratik në rend hierarkik varësie, duke filluar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për mallrat e grupit C, ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit për mallrat e grupit B dhe Kryeministri për mallrat e grupit A.

Argumentet dhe arsyetimi i Presidentit për mosdekretimin e ligjit nr. 36/2019 nuk qëndrojnë.

Regjimi juridik i administrimit dhe lëvrimit të mallrave rezervë të shtetit nuk dobësohet në asnjë rast:

**Së pari**, referuar nenit 3, të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008:

*“Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Rezervat*

*materiale të shtetit përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.”*

Pra, siç sanksionohet në këtë dispozitë të ligjit, është ndërhyrja në mënyrë të menjëhershme, për t'i ardhur në një kohë sa më të shpejtë në ndihmë popullsisë, ekonomisë dhe mbrojtjes së vendit, situatave të cilat mund të krijohen si nga shkaqe natyrore apo për shkaqe të krijuar si rezultat i veprimtarisë njerëzore. Gjatë këtyre viteve kemi pasur shpesh situata të emergjencave, të cilat kërkonin lëvrimin e menjëhershëm të mallrave të kategorisë A, më konkretisht mjetet e tonazhit të lartë dhe për shkak të procedurës aktuale (hartim projektvendimi dhe praktike shoqëruese, marrje mendimi nga ministritë e linjës dhe miratimi në një nga mbledhjet javore të KM) nuk është arritur të lëvrohen në kohë.

**Së dyti**, arsyetimi i Presidentit se ndërmarrja (nisma) ligjore për miratimin e ligjit nr. 36/2019, është e pajustificuar dhe bie ndesh me rendin kushtetues dhe argumentimi i tij për cenimin e interesit publik nga kjo iniciativë për ndryshimin përkatës në legjislacionin ekzistues, nuk qëndron, pasi nisma dhe kërkesa për ndryshimin e ligjit vjen nga vetë struktura e cila ka përgjegjësinë ligjore për administrimin e mallrave rezervë të shtetit. Gjithashtu, për miratimin e ligjit është ndjekur e gjithë praktika dhe procedurat ligjore të parashikuara për miratimin e projektligjit në Kuvend, sipas VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. Pra, për këtë projektligj Këshilli i Ministrave në cilësinë e organit që e ka pasur këtë të drejtë, jo vetëm që ka shprehur dakordësinë për këtë nismë, por edhe ka qenë po ky organi i cili ka propozuar ndryshimin e ligjit në Kuvend.

Argumenti se **lëvrimi i mallrave pjesë e rezervës shtetërore, sipas mënyrës së re nëpërmjet urdhrit të Kryeministrit, nuk garanton plotësisht mbrojtjen e interesit publik në procedurat e administrimit dhe lëvrimin të mallrave që përbëjnë mallrat e grupit kryesor rezervë të shtetit**, nuk qëndron pasi edhe pse lëvrimi i mallrave të grupit A, sipas ndryshimeve ligjore, bëhet me urdhër të Kryeministrit, ky akt administrativ edhe pse është individual, para se të nënshkruhet i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë si për çdo akt tjetër nga strukturat kompetente për garantimin e ligjshmërisë së akteve administrative.

Nëse do të vijojmë në logjikën e argumentimit të Presidentit, mallrat e grupit B dhe mallrat e grupit C, të cilat lëvrohen me akte individuale, duhet të kishin sjellë cenim të interesit publik, ndërkohë që deri më sot nuk ka pasur raste të tilla. Pra, fakti se lëvrimi i mallrave rezervë të shtetit bëhet nga një organ monokratik apo kolegjal nuk lidhet kurrësi me cenimin e interesit publik.

Gjithashtu, në vijim të sa më sipër, referuar nenit 100 të Kushtetutës së RSH-së, nenit 28, të ligjit 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe Kreut II, të VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, aktet e miratuara nga Këshilli i Ministrave janë të karakterit normativ dhe atij individual.



Aktet e karakterit normativ janë akte të përgjithshme dhe abstrakte që rregullojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse një çështje të caktuar. Hierarkia superiore e VKM-së shprehet edhe në faktin se në zbatim të tyre dalin urdhra dhe udhëzime të ministrave të linjës. Për vetë natyrën e tyre, vendimet e Këshillit të Ministrave rregullojnë një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk janë të shteruar në zbatimin e tyre.

Aktet individuale të nxjerra nga Këshilli i Ministrave janë në numër të kufizuar Aktet individuale të nxjerra nga Këshilli i Ministrave mund të përkufizohen në të njëjtën mënyrë me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative për aktin administrativ individual, i cili është:

*“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektësh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.*

Për këtë arsye, duke qenë se akti i Këshillit të Ministrave për lëvrimin e mallrave rezervë të shtetit, të klasifikuara në kategorinë A, për nga karakteri nuk është akt normativ dhe as individual, por që më së shumti i ngjason një autorizimi, për nxjerrjen e tij, nuk duhet të përbëjë domosdoshmëri ndjekja e procedurave standarde të miratimit të një akti normativ apo individual.

**Së treti, në arsyetimin e tij Presidenti argumenton se nisur nga rëndësia dhe vlera që kanë mallrat e grupit A të rezervave materiale të shtetit është në interes të publikut të gjerë që kontrolli ndaj çdo veprimi administrativ mbi këto mallra të jetë maksimal dhe jo një marrëdhënie midis dy autoriteteve politike Ministër–Kryeministër, ku padyshim kjo marrëdhënie varësie midis tyre mund të ndikojë drejtpërdrejt në objektivitetin e vendimmarrjes.**

Nisur nga një analizë e thjeshtë e këtij arsyetimi, arrijmë në përfundimin se ky argumentim nuk qëndron për faktin se raporti i varësisë Këshill i Ministrave - Ministër është i ngjashëm me atë Kryeministër – Ministër, pasi Këshilli i Ministrave është organ kolegjal, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje ministrat.

Sa më sipër, sjellim edhe një herë në vëmendje se lëvrimi i mallrave rezervë të shtetit nëpërmjet aktit kolegjal vetëm do të shtonte procedurat, burokracinë dhe vonesat për lëvrimin e tyre në mënyrë operationale dhe efektive. Lëvrimi i mallrave rezervë të grupit A me urdhër të Kryeministrit nuk nënkupton lëvrimin e tyre jashtë kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, pasi edhe në këto raste akti administrativ individual i nënshtrohet kontrollit ligjor para nënshkrimit nga strukturat kompetente të ngarkuara me ligj, për garantimin e ligjshmërisë së tij.

Sa u argumentua më lart, nisma ligjore për ndryshimin e nenit 10, pika 1, e ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, është e ligjshme, është e justifikuar dhe nuk cenon interesin publik në administrimin e mallrave rezervë të shtetit.

Gjatë diskutimeve në Komision u vu edhe njëherë theksi tek fakti se, operimi sipas ndryshimit të propozuar nga Ministria e Mbrojtjes rrit përgjegjësinë e vendimmarrjes, pasi dihet se përgjegjësia kolektive nuk përbën përgjegjësi penale, ndryshe nga ajo në rastin e ushtrimit të një përgjegjësie individuale sikundër është edhe rasti i ndryshimit të propozuar me ligjin nr.36/2019.

- ***Përfundime***

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, votoi pro rrëzimit të Dekretit të Presidentit nr. 11225, datë 15.07.2019 dhe kalimin e tij seancës plenare në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**Relatore**

**Antoneta DHIMA**

**Kryetare**

**Ermonela (Felaj) VALIKAJ**